



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref.nr. *01/2382* Dt. *05/08* / 2025

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, dhe Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik Ref.nr.01/1328 të dt. 26.06.2024, në mbledhjen e mbajtur më datë 02.05.2025, 04.07.2025 dhe 30.07.2025 (online), vendos të shpall:

K O N K U R S

Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, për këto Fakultete:

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

Avancim ose riemërim

1. Një mësimdhënës/e për lëndët: Filozofi e edukimit (Parashkollor), Filozofi e edukimit (Fillor); Menaxhimi i klasës (Parashkollor); Praktikë pedagogjike I (Parashkollor); Praktikë pedagogjike I (Fillor); Praktikë pedagogjike II (Parashkollor); Praktikë e mësimdhënies (master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë).
2. Një mësimdhënës/e për lëndët: Letërsi për fëmijë (Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor); Edukimi dhe mediat (Arsimi Parashkollor); Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla (Arsimi Parashkollor); Letërsi popullore (Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Tipologji e letërsisë shqipe (Master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe).
3. Një mësimdhënës/e për lëndët: Pedagogji e edukimit parashkollor (3 orë, Arsimi Parashkollor); Praktikë pedagogjike II (Arsimi Fillor); Strategjitë e edukimit parashkollor (Arsimi Parashkollor); Kurrikulla shkollore (Master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor); Mësimi i bazuar në projekte (Master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor); Shkolla dhe komuniteti (Arsimi Fillor).



Emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse

1. Një mësimdhënës/e për lëndët: Hyrje në psikologji (Parashkollor), Hyrje në psikologji (Fillor), Psikologji zhvillimore (Parashkollor), Puna me fëmijët e talentuar (Parashkollor), Zhvillimi profesional (Parashkollor), Psikologji e zbatuar në mësimdhënie (Master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor).
2. Një mësimdhënës/e për lëndët: Metodologji e edukimit fizik (Parashkollor), Metodologji e edukimit fizik (Fillor), Edukimi fizik i fëmijëve (Parashkollor), Lojërat popullore tradicionale (Parashkollor), Kurrikula e edukimit fizik (Master Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor).
3. Një mësimdhënës/e për lëndët: Mësimi i gjuhës angleze përmes TI (Master Mësimdhënie e Gjuhës Angleze), Teknologji arsimore (Master Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe), Bazat e teknologjisë informative (Ekonomik), Teknologjia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare (Shkencat Sociale); Teknologji informative (Fillor); Sistemet kompjuterike (Fillor).
4. Një mësimdhënës/e për lëndët: Orientimi (zhvillimi) profesional (Arsimi Fillor); Edukimi në fëmijërinë e hershme (Arsimi Parashkollor); Komunikimi në edukim (Parashkollor); Komunikimi në edukim (Parashkollor); Arsimi gjithëpërfshirës (Mësimdhënie e Gjuhës Angleze); Praktikë pedagogjike (Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor).
5. Një mësimdhënës/e për lëndët: Edukatë shëndetësore (Arsimi Parashkollor); Shëndeti publik (Arsimi Parashkollor); Edukatë shëndetësore (Arsimi Fillor); Shëndeti publik (Arsimi Fillor) me plotësim norme në fakultetet e tjera.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse

1. Një mësimdhënës/e për lëndët: Teoria e kontrollës dhe praktikat, Sistemet e bazuara në senzore, Mekatronikë, Senzore dhe Elektronika, Automatizimi Industrial dhe Inteligjenca Artificiale.

III. FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

Emërim për herë të parë në thirrjen përkatëse

1. Një mësimdhënës/e, për lëndët: Historia e marrëdhënieve ndërkombëtare, Historia e Evropës, Shkathtësitë akademike, Historia e Luftës së Ftohtë, EU-ja dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor, Siguria ndërkombëtare, teoritë dhe konceptet, Demokracia, shteti dhe konfliktet rajonale.



1. Kushtet e përgjithshme

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, dhe Rregulloren Nr.01/1328 dt.26.06.2024 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

2. Dokumentet e nevojshme për aplikim

Kandidatët të cilët aplikojnë për pozitat në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim
- b) Biografinë (CV);
- c) Certifikatën e lindjes;
- d) Certifikatën e shtetësisë
- e) Diplomat origjinale ose kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë) të vërtetuara nga noteri (me vulë origjinale të noterit). Në pozitat e shpallura nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, kandidatët duhet të kenë doktoratë nga fushat përkatës si: Shkenca Teknologjike, Shkenca Kompjuterike, Mekatronikë, Automatikë, Robotikë.
- f) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit duhet të sjellin vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë).
- g) Certifikatën e notave origjinale ose kopjet të tri nivelet e studimit (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë) të vërtetuara nga noteri (me vulë origjinale të noterit).
- h) Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- i) Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- j) Dëshmi nga Gjykata Themelore, se ndaj tij/saj nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- k) Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore - njohja e gjuhëve të huaja është një përparësi për kandidatët.

3. Mënyra e aplikimit

1. Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit dhe së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzojnë në formë fizike dhe në formë elektronike.
2. Dokumentacioni në formë fizike duhet të dorëzohet në zyrën e arkivës AZ/04 në UKZ, kurse versioni elektronik (pasi të protokolohej kërkesa) të dërgohet në **info@uni-gjilan.net**.
3. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara si dhe ato që nuk deponohen të skanuara në adresën e lartëcekur nuk do të merren në shqyrtim.
4. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit, përkatësisht nga data **05.08.2025** deri më **19.08.2025** në orën **16.00**.
5. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:

<http://www.uni-gjilan.net>

